


Eco-Connect

NATYRA DHE EKONOMIA NË HARMONI



Projekti: "Eco-Connect "Natyra dhe Ekonomia në Harmoni"

Aplikanti: Nucleus Albania

Vlera: 1.200.000 Lekë

Vendodhja: Ndroq, Tiranë

Kohëzgjatja: 15 Janar – 15 Qershor 2026

Qëllimi i përgjithshëm

Të fuqizojë fermerët, sipërmarrësit ruralë në zonën e Ndroqit përmes zhvillimit të një modeli të qëndrueshëm të agroturizmit dhe zinxhirit të vlerës në bujqësi; të rrisë kapacitetet njerëzore, të krijojë mundësi të reja ekonomike për gratë dhe të rinjtë dhe të forcojë lidhjet mes prodhimit bujqësor dhe turizmit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të kësaj zone. Nëpërmjet përmirësimit të praktikave bujqësore, diversifikimit të produkteve dhe promovimit të turizmit të bazuar në burimet lokale, projekti do të mbështesë një model zhvillimi të qëndrueshëm që përfiton drejtpërdrejt komunitetin lokal, redukton emigracionin rural dhe ruan trashëgiminë natyrore dhe kulturore të zonës, parandalon efektet klimatike në natyrën dhe ekonominë e zonës.

Ideja projektit:

Projekti synon zhvillimin e një modeli agroturistik të qëndrueshëm në zonën e Ndroqit, duke integruar turizmin natyror dhe të aventurës me zhvillimin ekonomik, lokal dhe mbrojtjen e mjedisit. Përmes krijimit dhe shenjëzimit të një shtegu turistik që lidh ullishtat, vreshtat, liqenet dhe atraksione natyrore, kulturore e fetare, projekti promovon produktet lokale, traditat dhe biodiversitetin e zonës.

Projekti fuqizon gratë dhe të rinjtë përmes trajnimeve të përshtatura dhe përfshirjes aktive në guidat turistike, mikpritjen dhe shërbimet agroturistike, duke krijuar mundësi punësimi dhe përmirësim të kushteve të jetesës për grupet e pafavorizuara. Ai mbështet fermerët në rritjen e vlerës së produkteve të tyre dhe nxit iniciativa miqësore ndaj mjedisit, të përshtatura ndaj ndryshimeve klimatike.

Shtegu agroturistik

Ndroq-Pinet-Sauqet-Liqenet e Sabielit-Çalabërzezë do të diversifikojë ofertën turistike lokale, do të forcojë ekonominë e zonës dhe do të shërbejë si një model i replikueshëm për zhvillimin e agroturizmit të qëndrueshëm në Shqipëri, bazuar në përvojat e suksesshme të Nucleus Albania.

Qasja jonë:

Qasje e integruar agroturizmi i qëndrueshëm: lidh zhvillimin ekonomik lokal me ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit.

Qasje komunitare: vendos në qendër komunitetin e Ndroqit, fermerët dhe familjet pritëse.

Qasje e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale: fuqizon gratë, të rinjtë dhe grupet e pafavorizuara përmes roleve aktive dhe mundësive të punësimit.

Qasje e zhvillimit të kapaciteteve: trajnime "tailor-made" për guida lokale, mikpritje, bujqësi dhe biodiversitet.

Qasje e turizmit të natyrës & aventurës: krijim/identifikim/shënjestim/markim i shtegut dhe zhvillim i përvojave përgjatë itinerarit (ferma, bletari, atraksione natyrore e kulturore etj.).

Qasje digjitale & interpretimi mjedisor: tabela informuese (hartë) dhe publikim i itinerarit në Wikiloc për akses më të lehtë.

Qasje partneriteti dhe replikueshmërie: bashkëpunim me aktorë lokalë dhe ndërtim i një modeli që mund të përsëritet në zona të tjera.

Objektivat:

Objektivi i përgjithshëm:

Të zhvillohet dhe implementohet një model agroturistik i qëndrueshëm që integron bujqësinë, gastronominë dhe turizmin me ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore. Ky model do të krijojë mundësi të reja ekonomike dhe punësimi për gratë dhe të rinjtë, duke nxitur zhvillimin lokal dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Objektivat specifike:

SO1: Krijimi dhe testimi i shtegut agroturistik, duke ofruar përvojë unike dhe promovuar praktikat e qëndrueshme.

SO2: Fuqizimi i komunitetit lokal, me fokus te gratë dhe të rinjtë, përmes trajnimeve dhe përfshirjes në aktivitete agroturistike, duke promovuar ekonominë e gjelbër.

Rezultatet:

- Krijimi dhe testimi i një itinerari/shtegu agroturistik
- Fuqizimi i komunitetit lokal përmes trajnimeve
- Promovimi i modelit agroturistik dhe përfshirja e komunitetit

KONTAKT
Nucleus Albania

Rruga: Reshit Çollaku, Pallati Bora, Shk.1, Ap.19
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 225 8312
E-mail: info@nucleus.al
Web: www.nucleus.al